



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Ac.nr.10385/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Lumni Sallauka - kryetar i kolegjit, Hunaida Pasuli dhe Ardian Ajvazi, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses R.S, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson A.K, avokat në....., kundër të paditurës Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës – SHSKUK, me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson T.I, me objekt të padisë kompensimin e pagës jubilarë, duke vendosur sipas ankesës së palës së paditur, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.2276/20, të datës 26.01.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur më **19.09.2022**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e të paditurës Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës – SHSKUK, me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.2276/20, i datës 26.01.2021, **VERTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.2276/20, të datës 26.01.2021, në pikën I të dispozitivit ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses R.S nga, ndërsa në pikën II të dispozitivit e ka detyruar të paditurën Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës – SHSKUK, me seli në Prishtinë, që paditëses në emër të shpërblimit jubilar në vlerë të dy pagave jubilarë t’ia paguaj shumën prej 754.00 €, me kamatë prej 8 % e cila do të llogaritet nga data 16.01.2021 kur është parashtruar padia e gjerë në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përbarimit të detyrueshëm. Në pikën III të dispozitivit gjykata e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit për tej shumës së gjykuar edhe atë: 163.00 €, ndërsa në pikën IV të dispozitivit e ka detyruar të paditurën që paditëses t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 259 €.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor, ka paraqitur ankesë pala e paditur, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të

plotë të gjendjes faktike, si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me të cilën ka kërkuar nga Gjykata e Apelit që ta aprovojë këtë ankesë si të bazuar dhe aktgjykimin e atakuar ta ndryshoj.

Pala paditëse nuk ka parashtruar përgjigje në ankesën e të paditurit.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e të paditurës është e **pathemeltë**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja me padinë e parashtruar në gjykatë, ka kërkuar që të detyrohet e paditura Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës – SHSKUK, me seli në Prishtinë, që paditësit, t'ia paguaj shpërblimin jubilar në vlerë të dy pagave jubilarë në shumën prej 917.16 euro për 20 vite përvojë pune në institucionin shëndetësorë, me kamatë ligjore prej 8 %, nga data e paraqitjes së padisë në gjykatë e deri në përmbushjen e plotë të detyrimit, si dhe t'ia kompensoj të gjitha shpenzimet e procedurës gjyqësore, sipas tarifës ligjore, duke përfshirë shpenzimet e procedurës kontestimore në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Gjykata e shkallës së parë ka mbajtur shqyrtimin kryesor dhe pas administrimit dhe shqyrtimit të provave si në vijim: kontratën e punës për kohë të pacaktuar e QKUK-së e datës 09.12.2012, kërkesën për kompensimin e dy pagave jubile me nr. Të protokollit nr.2170 e datës 11.03.2020, listën e pagave e të paditurës e datës 25.02.2020, vërtetimin mbi përvojën e punës të QKUK-së si dhe pasqyrën bankare e NLB Bank e datës 09.02.2020, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimi të atakuar gjykata ka theksuar se mes palëve ndërgjyqëse nuk ka qenë kontestuese se pala paditëse është në marrëdhënie pune tek e paditura sipas kontratës së punës për kohë të pacaktuar e QKUK-së e datës 09.12.2012, si dhe nga vërtetimi i lëshuar nga SHKUK, është vërtetuar se paditësja ka përvojë punë mbi 20 vite tek e paditura. Ndërsa lartësinë e pagës mujore gjykata e vërtetoi në bazë të listës së pagave të paditurës të datës 25.02.2020. Vendimin mbi kamatën gjykata e shkallës së parë e ka mbështetur në dispozitat e nenit 382 të LMD-së, ndërsa vendimin mbi shpenzimet e procedurës e ka mbështetur në dispozitën nga neni 452 i LPK-së.

Gjykata e Apelit e aprovon në tërësi vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të pretenduara dhe as në shkeljet nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe rrjedhimisht nuk ka aplikim të gabuar të drejtës materiale për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Si rrjedhojë, gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe faktet vendimtare si marrëdhënia e punës si dhe përvoja e punës së paditëses tek e paditura mbi 21 vjet, nuk kanë qenë kontestuese.

Me nenin 4 par.3 të Kontratës Kolektive Sektoriale, e cila ka hyrë në fuqi nga data 11.06.2018, në të cilën dispozitë është përcaktuar se *“Përfitues të beneficioneve të cilat dalin nga kjo marrëveshje dhe të cilat bazohen në Ligjin e Punës janë të gjithë punëtorët shëndetësor, ndërsa beneficionet/dobitë që dalin nga marrëveshjet e që nuk janë pjesë e Ligjit të Punës i gëzojnë vetëm anëtarët FSSHK-së”*. Si dhe neni 17 pika 3, 4 dhe 5 të kësaj kontrate përcakton se *“Punëmarrësi ka të drejtë në kompensimin e pagës së 13 (trembëdhjetë) për çdo vit kalendarik, në vlerën e pagës bazë, sipas mundësive buxhetore të punëdhënësit. Punëtorët shëndetësor, në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit në vlerë: 3.1. Për 10 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, në vlerë të një page mujore të tij; 3.2. Për 20 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, në vlerë të dy paga mujore të tij; 3.3. Për 30 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të tri paga mujore të tij. 4. Punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblime jubilarë. Shpërblimi jubilar, paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf.* Andaj, gjykata e shkallë së parë në mënyrë të drejtë ka zbatuara të drejtën materiale të referuara për këtë çështje juridike kontestuese nga ka rrjedhë edhe përfundimi për themelësinë dhe lartësinë e kërkesëpadisë.

Pretendimi ankimor i të paditurës se nuk ka qenë nënshkruese direkte e kontratës kolektive sektoriale, e nënshkruar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Federatës Sindikale të Shëndetësisë së Kosovës, me datë 08.06.2018, është i paqëndrueshëm për faktin se përgjegjësinë lidhur me pagimin e këtyre obligimeve, për të paditurën rrjedhin nga neni 17 paragrafi 4 i Kontratës Kolektive Sektoriale, ku parashihet se *“Punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblimet jubilarë. Shërbimi jubilar , paguhet në afat prej 1 muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf”*, dhe pretendimi i të paditurës për mungesë të linjës së veçantë buxhetore është i pabazuar, ngase e paditura si organ përgjegjës për punëtorët e saj, është obliguar që ta zbatoj këtë kontratë kolektive dhe me kohë të planifikoj buxhetin, andaj meqenëse paditësja ka qenë në marrëdhënie pune tek këtu e paditura nga viti 1999, e deri më tani, atëherë përgjegjësia për pagimin e shpërblimit jubilar bie mbi të paditurën.

Nga arsyet e lartcekura, Gjykata e Apelit e aprovon në tërësi arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë sa i përket vendosjes lidhur me aprovimin e kërkesëpadisë së

paditëses që në emër të shpërblimit të pagës jubilarë t'ia kompensojë shumën e aprovuar si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar. Gjithashtu edhe për lartësinë e kërkesëpadisë gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejtë dhe në mënyrë të ligjshme, pasi që në shkresat e lëndës ka pasur prova të mjaftueshme siç është kontrata e punës dhe vërtetimi për përvojën e punës, nga të cilat edhe është vërtetuar saktësisht lartësia e kërkesëpadisë, andaj dhe u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në këtë drejtim edhe vendimi për shpenzimet e procedurës është në përputhje me nenin 452 të LPK-së, dhe sa i përket lartësisë është në harmoni me tarifën e Odes së Avokatëve dhe tarifat për shpenzime gjyqësore. E drejta materiale, përkatësisht neni 382.2 i LMD-së, është zbatuar në mënyrë të drejtë edhe sa i përket kërkesës aksesore përkitazi me kamatën.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, pasi që gjykata e shkallës së parë ka dhënë qëndrimin e saj juridik lidhur me to, të cilin e pranon në tërësi edhe kjo gjykatë e shkallës së dytë, për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 par. 1 pika d) të LPK-së, lidhur me neni 200 të LPK-së, u vendosë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.10385/2021, datë 19.09.2022

Kryetari i kolegjit,

Lumni Sallauka